KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

# PROGRAMI I PUNËS

SË

ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

**2026**

**MIRATOI:**

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

www.idp.al

# HYRJE

Viti 2026 shënon një periudhë me rëndësi të veçantë për Shqipërinë në kuadër të avancimit të procesit të integrimit evropian. Pas miratimit më 11 tetor 2024 të Dokumentit të Anëtarësimit - Qëndrimit të Përbashkët të Bashkimit Evropian për Grupkapitullin 1 "Themelorët", janë përcaktuar piketa të rëndësishme për përmbushjen e kritereve të anëtarësimit.

Paralelisht, Zyra e Komisionerit vijon përmbushjen e angazhimeve të përcaktuara në Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës dhe Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike, të cilat përbëjnë objektiva themelore në kuadër të procesit të integrimit dhe të forcimit të institucioneve të pavarura.

**Misioni Institucional**

Misioni i Zyrës së Komisionerit konsiston në garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, përmes monitorimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të kuadrit ligjor në fushën e të drejtës së informimit, mbrojtjes së të dhënave personale, të dhënave të hapura dhe ripërdorimit të informacionit publik.

Ky mision përfaqëson bazën mbi të cilën ndërtohen politikat, programet dhe veprimet institucionale që synojnë rritjen e transparencës, forcimin e mbrojtjes së të dhënave dhe zhvillimin e qeverisjes së hapur.

**Qëllimi i Programit të Punës**

Zyra e Komisionerit ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Programin e Punës, i cili hartohet mbi bazën e Rezolutës vjetore të Kuvendit dhe në përputhje me dokumentet strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare përkatëse.

Programi ndërtohet mbi prioritete dhe objektiva të qarta, me synimin për të siguruar përmbushjen sa më efektive të misionit institucional dhe forcimin e kapaciteteve organizative të Zyrës.

**Prioritetet për vitin 2026**

Për vitin 2026, prioritetet kryesore të Zyrës së Komisionerit fokusohen në:

- zbatimin e plotë të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- forcimin e kuadrit nënligjor, përmes zbatimit të 10 akteve të miratuara nga Zyra e Komisionerit në këtë fushë;
- promovimin e së drejtës për informim në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke udhëhequr Presidencën dhe Sekretariatin e ICIC për periudhën 2025–2027;
- monitorimin e zbatimit të ligjit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit publik;
- zhvillimin e bashkëpunimit institucional dhe ndarjen e praktikave të mira me autoritetet homologe në vende të tjera;
- fuqizimin institucional të Zyrës përmes përmirësimit të proceseve të brendshme, rritjes së kapaciteteve profesionale dhe përdorimit të teknologjive mbështetëse.

Korniza ligjore sipas së cilës Zyra e Komisionerit përmbush misionin e saj është si në vijim:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 45/2022 *"Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për aksesin në dokumente zyrtare"";*
- Ligji nr. 8137/1996 *"Për ratifikimin e Konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9288/2004 *"Për ratifikimin e Konventës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale", i ndryshuar;*
- Ligji nr. 49/2022 *"Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale";*
- Ligji nr. 119/2014 *"Për të drejtën e informimit",* i ndryshuar;
- Ligji nr. 124/2024 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale";*
- Ligji nr. 33/2022 *"Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik";*
- Ligji nr. 146/2014 *"Për njoftimin dhe konsultimin publik";*
- Ligji nr. 113/2018 *"Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it";*
- Ligji nr. 38/2025 *"Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë";*
- Ligji nr. 39/2025 *"Për kontrollin e kufirit shtetëror";*
- Ligji nr. 19/2016 *"Për masat shtesë të sigurisë publike".*

Aktet rregullatore mbi bazën e të cilave është organizuar puna e Zyrës së Komisionerit janë si në vijim:

- Urdhër i Komisonerit nr. 21, datë 30.01.2026 për "Miratimin e strukturës dhe organikës të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale";
- Strategjia Institucionale e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Rregullore e brendshme e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Plani i Integritetit i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit bazohet në parimet e trajtimit të barabartë dhe gjithëpërfshirës, profesionalizmit, pavarësisë dhe integritetit, paanësisë, transparencës, efektivitetit dhe eficiencës në garantimin e të drejtave, përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

# OBJEKTIVA ME PRIORITET

| OBJEKTIVI | MASAT E PËRGJITHSHME | NJËSIA PËRGJEGJËSE | PERIUDHA | PRODUKTI |
|---|---|---|---|---|
| Presidenca - Sekretariati i ICIC. | Planifikimi dhe organizimi i takimeve të Komitetit Ekzekutiv ICIC.<br><br>Organizimi, koordinimi dhe dhënia e kontributit në sesionet e Komitetit të Planifikimit ICIC për edicionin e Sierra Leone në 2026.<br><br>Ndjekja e të gjitha proceseve administrative dhe procedurave të punës të Sekretariatit të ICIC dhe koordinimi i punëve me anëtarët dhe aktorët e ndryshëm.<br><br>Përfaqësimi dhe promovimi i komunitetit të ICIC në forume ndërkombëtare dhe aktiviteteve të tjera me aktorë të ndryshëm.<br><br>Përgatitja e dokumenteve dhe raporteve në përmbushje të funksioneve përkatëse.<br><br>Monitorimi i organizimit të ICIC Sierra Leone 2026 dhe përgatitja e agjendës së sesionit të mbyllur të tij. | Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit<br><br>Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës<br><br>Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë | Janar-Dhjetor 2026 | Kryesimi dhe realizimi i të gjitha funksioneve të Presidencës-Sekretariatit të ICIC dhe të gjitha aktiviteteve të tjera që lidhen me të. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Organizimi i Konferencës VIII Kombëtare "*E drejta për informim*" | Hartimi i Programit të masave dhe bashkërendimi i punës për përgatitjen dhe monitorimin e zbatimit të aspekteve logjistike të Konferencës. | Kabineti/Këshilltari për Median<br><br>Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit<br><br>Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës<br><br>Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë | Dhjetor 2026 | Zhvillimi i Konferencës së VIII Kombëtare me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të autoriteteve publike dhe grupeve të interesit. |
| Kremtimi i Ditës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale - 28 Janar 2026. | Aktivitet ndërgjegjësues me fokus mjedisin digjital dhe përdorimin e sigurt të teknologjisë | Kabineti/Këshilltari për Median<br><br>Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale<br><br>Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës | Janar 2026 | Njohja, ndërgjegjësimi dhe promovimi në tërësi i të drejtës themelore të individit për mbrojtjen e të dhënave personale. |
| Kremtimi i Ditës Ndërkombëtare të së Drejtës për Informim - 28 Shtator 2026. | Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese për qytetarët/administratën publike me qëllim përmbushjen e të drejtës për t'u njohur me informacion publik, nëpërmjet zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit. | Kabineti/Këshilltari për Median<br><br>Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit<br><br>Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës | Shtator 2026 | Njohja, ndërgjegjësimi dhe promovimi në tërësi i të drejtës themelore të individit për të drejtën e informimit. |
| Hartimi dhe miratimi i Raportit Vjetor 2025. | Bashkërendim institucional me qëllim mbledhjen e informacioneve dhe statistikave në lidhje me veprimtarinë vjetore institucionale. | Sekretari i Përgjithshëm<br>Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integrimit në koordinim me të gjitha strukturat e tjera të institucionit. | Mars 2026 | Raporti Vjetor 2025, i miratuar.<br><br>Rezolutë për veprimtarinë e institucionit nga Kuvendi i Shqipërisë, e miratuar. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Përgatitja e Raportit Vjetor 2025 dhe depozitimi i tij në Kuvendin e Shqipërisë.<br><br>Prezantimi i Raportit Vjetor 2025 në Komisionin për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale, në Komisionin për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik si dhe në seancë plenare. | | | |
| Hartimi i Strategjisë Institucionale për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2026-2030. | Bashkëpunim me projektin PACEP me qëllim hartimin e Strategjisë Institucionale për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2026-2030 dhe Planin e Veprimit të saj.<br><br>Hartimi i draftit të Strategjisë Institucionale për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2026-2030 dhe Planin e Veprimit të saj.<br><br>Hedhja për konsultim e Strategjisë Institucionale për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2026-2030 dhe Planin e Veprimit të saj.<br><br>Monitorimi i objektivave në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit për vitin 2026 të Strategjisë Institucionale 2026-2030. | Sekretari i Përgjithshëm<br><br>Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integrimit<br><br>Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit<br><br>Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale | Mars 2026<br><br>Dhjetor 2026 | Strategjia Institucionale për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2026-2030 dhe Planin e Veprimit të saj, i miratuar.<br>Objektiva strategjike të realizuar në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Forcimi i kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit për menaxhimin e hapur të të dhënave, përmes trajnimeve të certifikuara të ofruara nga ASPA. | Bashkëpunime me projekte dhe institucione ndërkombëtare me qëllim forcimin e kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit.<br><br>Zhvillimi i takimeve/ trajnimeve/ workshop. | Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit<br><br>Drejtoria për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik | I vazhdueshëm 2026 | Kapacitete të rritura të Zyrës së Komisionerit, personave të kontaktit dhe nëpunësve të administratës publike. |
| Përmbushja e piketës së ndërmjetme hapëse e parashikuar në Dokumentin e Anëtarësimit: *“Qëndrimi i Përbashkët i Bashkimit Evropian-Grupkapitulli 1: “Themelorët”.* | Realizimi i piketës së ndërmjetme hapëse: *“Miratimi dhe fillimi i zbatimit të reformës për mbrojtjen e të dhënave në përputhje me acquis-në e BE-së, duke përfshirë reagimin sistematik dhe marrjen e masave mbrojtëse efikase për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale”*.<br><br>Përgatitja e kontributit dhe pjesëmarrje aktive në takimet periodike të Komisionit Evropian mbi ecurinë e zbatimit të piketave të ndërmjetme. | Sekretari i Përgjithshëm<br><br>Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale<br><br>Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integrimit | Janar - Dhjetor 2026 | Përgatitja e 3 drafteve të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”<br><br>Progres në zbatimin e piketës së ndërmjetme hapëse të parashikuar në Dokumentin e Anëtarësimit. |
| Përmbushja e objektivave të parashikuara për Zyrën e Komisionerit në Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023–2030. | Realizimi i masave të parashikuara në këtë dokument për vitin 2026.<br><br>Përgatitja e raportimeve periodike mbi përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ky dokument. | Sekretari i Përgjithshëm<br><br>Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit<br><br>Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integrimit | Janar - Dhjetor 2026 | Masat e parashikuara për vitin 2026, të realizuara. |
| Përmbushja e objektivave të parashikuar për Zyrën e Komisionerit | Realizimi i masave të parashikuara në këtë dokument për vitin 2026.<br><br>Në përputhje me rekomandimet e lëna në Udhërrëfyesin për Shtetin e së | Sekretari i Përgjithshëm | Janar – Dhjetor 2026 | Masat e parashikuara për vitin 2026, të realizuara. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës 2023- 2030. | Drejtës 2023-2030, përgatitja e raportimeve periodike mbi përmbushjen e rekomandimeve/detyrimeve, që dalin nga ky dokument. | Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale<br><br>Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integrimit | | |
| Forcim dhe rritje kapacitetesh i koordinatorëve, personave të kontaktit për të dhënat e hapura dhe Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues mbi të drejtën e informimit, ripërdorimin e informacionit publik dhe të dhënat e hapura. | Bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike lidhur me hartimin e kurrikulave mbi ripërdorimin e informacionit publik dhe të dhënat e hapura dhe zhvillimin e trajnimeve të fushës.<br><br>Trajnim i personave të kontaktit për të dhënat e hapura në organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike me qëllim përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 33/2022 dhe publikim e listës së të dhënave të hapura. | Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit<br><br>Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës<br><br>Drejtoria për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik | Dhjetor 2026 | Në përmbushje të objektivave të parashikuar për vitin 2026 për Zyrën e Komisionerit në Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023-2030, të gjithë koordinatorët për të drejtën e informimit të trajnuar dhe certifikuar nga ASPA dhe Komisioneri, mbi të drejtën e informimit, ripërdorimin e informacionit publik dhe të dhënat e hapura.<br><br>Persona kontakti për të dhënat e hapura të trajnuar dhe certifikuar nga ASPA dhe Komisioneri, mbi të drejtën e ripërdorimit të informacionit publik dhe të dhënat e hapura.<br><br>Zbatim më efektiv i legjislacionit për të dhënat e hapura. |
| Forcimi i kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit për menaxhimin e hapur të të dhënave, përmes | Bashkëpunime me projekte dhe institucione ndërkombëtare me qëllim forcimin e kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit. | Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit | Janar – Dhjetor 2026 | Kapacitete të rritura të Zyrës së Komisionerit, personave të kontaktit dhe nëpunësve të administratës publike. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| trajnimeve të certifikuara të ofruara nga ASPA. | Zhvillimi i takimeve/trajnimeve/ workshop. | Drejtoria për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik | | |
| Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese për zbatimin e legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale; | Aktiviteteve ndërgjegjësuese:<br>- me kontrollues publikë/privatë në sektorë të ndryshëm;<br>- me fëmijët viktima, në kontakt/konflikt me ligjin, si dhe në sistemin arsimor të vendit (*mësues, nxënës, student, staf akademik/administrative*);<br>- me nxënës për sigurinë në Internet, privatësinë, ndarjen e informacionit dhe antiviruseve<br>- trajnime me qëllim rritjen e aftësive të profesionistëve (psikologë, punonjës social, punonjës policie, prokurorë etj.) mbi detyrimet e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale për viktimat e krimit;<br>- trajnime me qëllim rritjen e aftësive të nëpunësve të ngarkuar me mbledhjen e të dhënave të migracionit;<br>- me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) në kuadër të detyrimeve të parashikuara në marrëveshjen me Eurojust; | Kabineti/Këshilltari për Median<br><br>Sekretari i Përgjithshëm<br><br>Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale<br><br>Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës | Janar – Dhjetor 2026 | Kontrollues të sektorëve të ndryshëm, të ndërgjegjësuar dhe të trajnuar mbi risitë e ligjit nr.124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*".<br><br>Garantimi i respektimit të të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe mbrojtja e privatësisë nga organet dhe agjencitë ligjzbatuese.<br><br>Promovimi i legjislacionit të ri të fushës në sistemin arsimor të vendit, me programe të dedikuara për të gjitha grupmoshat, veçanërisht, për fëmijët dhe të rinjtë. |

- me organet ligjzbatuese me qëllim prezantimin e tyre me risitë që sjell Direktiva e Policisë, si pjesë integrale e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe detyrimeve të parashikuara në marrëveshjen me Eurojust;
- aktivitete ndërgjegjësuese mbi zbatimin dhe respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të përpunimit të të dhënave të pasagjerëve PNR/API;
- organizimi i takimeve/leksioneve të hapura me studentët e Fakultetit të Drejtësisë për t’u njohur me rolin dhe veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit;
- Realizimi dhe publikimi i materialeve informuese mbi ligjin nr. 124/2024.
- Trajnime për kualifikimin e Nëpunësve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale në bashkëpunim me Kolegjin Universitar të Biznesit.

# OBJEKTIVA NË VAZHDIMËSI

| DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **OBJEKTIVI** | **MASAT E PËRGJITHSHME** | **NJËSIA PËRGJEGJËSE** | **PERIUDHA** | **PRODUKTI** |
| Monitorim i përditësimit të Programit të Transparencës dhe Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të autoriteteve publike, Regjistrit Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPDI), në portalin pyetshtetin.al | Monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës sipas Urdhrit nr. 280, datë 30.12.2025, të Komisionerit.<br><br>Zhvillimi i hetimeve administrative.<br><br>Hartimi i akteve përfundimtare.<br><br>Monitorimi i zbatimit të Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore sipas Urdhrit nr. 281, datë 30.12.2025, të Komisionerit.<br><br>Monitorimi i zbatimit të përmbajtjes së “Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar”, sipas Urdhrit nr. 188, datë 18.12.2020 të Komisionerit.<br><br>Hartimi i Indeksit të Transparencës së AP qendrore dhe të varësisë dhe NJVV.<br>Hartimi i rekomandimeve të Komisionerit për institucionet e sistemit shëndetësor. | Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit<br><br>Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës | I vazhdueshëm | Të gjitha autoritetet publike qendrore/varësie të monitoruara.<br><br>Të gjitha NJVV të monitoruara.<br><br>Funksionalitet në rritje të portalit pyetshtetin.al.<br><br>Rekomandime të Komisionerit për institucionet e sistemit shëndetësor të hartuara dhe publikuara.<br><br>Indeksi i hartuar dhe publikuar.<br><br>REKPDI i instaluar në të paktën 15 autoritete publike. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Instalimi i REKPDI nga Zyra e Komisionerit në 15 autoritete të reja publike.<br><br>Përditësim i portalit pyetshtetin.al me informacion. | | | |
| Zhvillimi i auditimit të transparencës proaktive të autoriteteve publike, duke integruar qasje të përmirësuara metodologjike dhe verifikim praktik të informacionit të publikuar. | Analiza e praktikave dhe modeleve më të mira evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e auditimit të transparencës proaktive.<br><br>Hartimi dhe miratimi i metodologjisë së auditimit të transparencës proaktive, bazuar në standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar në fuqi.<br><br>Pilotimi i metodologjisë së auditimit të transparencës në të paktën tre autoritete publike, përmes vlerësimit në terren dhe analizës së përputhshmërisë së informacionit të publikuar. | Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit | Dhjetor 2026 | Njohuri e thelluar mbi standardet dhe praktikat më të mira në fushën e transparencës proaktive.<br><br>Sigurimi i një kornize standarde dhe të qartë për realizimin e auditimeve të ardhshme. |
| Monitorim/Përpunim të dhënash të raportuara nga autoritetet publike në zbatim të nenin 24/1 të Ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar (Në vijim “LDI”) | Dërgim kërkese për raportim sipas formatit të miratuar me Urdhrin nr. 1, datë 05.01.2026 nga Komisioneri dhe administrim i formularëve të raportuar nga ana e autoriteteve publike. | Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit<br><br>Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës | Mars 2026 | Të dhënat e agreguara të publikuara nga Zyra e Komisionerit. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zhvillimi i proceseve të rregullta të vlerësimit të ankesave dhe procedurave të trajtimit të tyre, në zbatim të legjislacionit për të drejtën e informimit. | Shqyrtimi dhe trajtimi i ankesave.<br><br>Zhvillimi i seancave dëgjimore.<br><br>Zhvillimi i inspektimeve pranë autoriteteve publike.<br><br>Ndjekja e çdo çështje nga inspektorët.<br><br>Pjesëmarrja në proceset gjyqësore, përfaqësimi dhe ndjekja e çështjeve në gjykatë. | Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit<br><br>Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave | I vazhdueshëm | Garantim aksesi në informacion publik për qytetarët.<br><br>Krijim i jurisprudencës në këtë fushë.<br>Ankesa të trajtuara.<br><br>Vendime.<br><br>Trend në rritje i vendimeve të Komisionerit të lëna në fuqi nga gjykatat. |
| Promovimi i zbatimit të legjislacionit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik. | Aktivitet ndërgjegjësues me grupet e interesit mbi të drejtat për ripërdorimin e të dhënave të hapura dhe përfitimet e tyre.<br><br>Aktivitet ndërgjegjësues me organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike mbi detyrimet që burojnë nga ligji nr.33/2022.<br><br>Realizimi dhe publikimi i materialeve informuese mbi ligjin për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik. | Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit<br><br>Drejtoria për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik | I vazhdueshëm | Qytetarë dhe grupet e interesit të ndërgjegjësuar mbi të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në ligjin nr.33/2022.<br><br>Ndërgjegjësimi i Organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike mbi detyrimet që burojnë nga ligji nr.33/2022. |
| Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik. | Monitorimi i publikimit të listës së dokumenteve ekzistuese që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura, nga organet e sektorit publik përgjegjëse për kategorinë e të dhënave mjedisore dhe të vëzhgimit të tokës. | Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit<br><br>Drejtoria për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik | I vazhdueshëm | Publikimi i listës së dokumenteve ekzistuese që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura, nga organet e sektorit publik në përmbushje të detyrimit të nenit 7/3 të ligjit nr. 33/2022 nga Ministria e Mjedisit dhe Institucionet e varësisë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Dërgimi i pyetësorëve organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike, me qëllim mbledhjen e të dhënave mbi zbatimin e ligjit nr.33/2022 prej tyre.<br><br>Kryerja e procedurave të hetimit administrativ kryesisht ose edhe në rastet e ankesave, deri në finalizimin e tyre. | | | përgjegjëse për publikimin e të dhënave mjedisore dhe të vëzhgimit të tokës.<br><br>Mbledhje të dhënash mbi implementimin e ligjit nr.33/2022 nga organet e sektorit publik dhe problematikat.<br><br>Rekomandime për organet e sektorit publik.<br><br>Shqyrtimi i ankesave.<br><br>Zhvillimi i seancave dëgjimore.<br>Vendime. |
| Kontribut në përafrimin/miratimin e legjislacionit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik. | Koordinim me MIE/institucionet përgjegjëse për procesin e përafrimit të plotë të ligji nr.33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik" me acquis të BE.<br>Koordinim me MIE/institucionet përgjegjëse për hartimin e akteve nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik". | Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit<br><br>Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integrimit<br><br>Drejtoria për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik | Dhjetor 2026 | Përafrimi i plotë i ligjit nr.33/2022 me Direktivën 2019/1024.<br><br>Akte nënligjore nga organi/et publike përgjegjëse rast pas rasti në koordinim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. |
| Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr.146/2014 *"Për njoftimin dhe konsultimin publik"*. | Shqyrtimi i ankesave.<br><br>Zhvillimi i seancave dëgjimore.<br><br>Bashkëpunim me institucionet dhe shoqërinë civile. | Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit<br><br>Drejtoria për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik. | I vazhdueshëm | Vendime.<br><br>Rekomandime mbi përmirësimin e procesit të konsultimit publik. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Forcimi i kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit dhe të organeve të sektorit publik për transparencën dhe menaxhimin e hapur të të dhënave, përmes trajnimeve të certifikuara të ofruara nga ASPA. | Bashkëpunime me projekte dhe institucione ndërkombëtare me qëllim forcimin e kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit.<br><br>Zhvillimi i takimeve/ trajnimeve/ workshop.<br><br>Trajnim i personave të kontaktit për të dhënat e hapura në organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike me qëllim përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji 33/2022 dhe publikim e listës së të dhënave të hapura.<br><br>Bashkëpunim me ASPA për të trajnuar mbi të dhënat e hapura. | Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit<br><br>Drejtoria për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik | I vazhdueshëm | Zbatim më efektiv i legjislacionit për të dhënat e hapura.<br><br>Kapacitete të rritura të stafit të Zyrës së Komisionerit dhe të personave të kontaktit e nëpunësve të administratës publike. |
| Përmirësimi i transparencës proaktive të bashkive nëpërmjet asistencës teknike të projektit të Bashki të Forta, zbatuar nga IDM. | Bashkëpunim me IDM për zbatimin e projektit “Bashki të Forta” .<br><br>Funksionimi i një Help-Desk-it për të mbështetur bashkitë për të realizuar transparencën institucionale.<br><br>Zhvillimi i të paktën 3 trajnimeve rajonale me koordinatorët e së drejtës për informim/sekretarët e keshillave të bashkive.<br><br>Bashkëhartim (KDIMDP/IDM) i raportit të përmbledhur mbi gjendjen e transparencës dhe rekomandimet për përmirësim | Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit<br><br>Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës | Dhjetor 2026 | Përmirësimi i transparencës proaktive të të gjitha bashkive në vend.<br><br>Forcim kapacitetesh të koordinatorëve të drejtës për informim/sekretarët e këshillave të bashkive të zhvilluara.<br><br>Raporti i publikuar dhe prezantuar në Kuvend/Komisionet përgjegjëse. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zhvillimi i fushatave informuese për edukimin ligjor të qytetarëve mbi të drejtën e tyre për të kërkuar dhe marrë informacion nga institucionet. | Fushata mediatike/dalje publike në media lidhur me të drejtën për informim.<br><br>Përgatitja e *Newsletter* mujor *"E drejta për informim"*. | Këshilltari për Median<br><br>Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit | Dhjetor 2026 | Rritja e edukimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve/publikut lidhur me të drejtat e tyre<br><br>*Newsletter* mujor i publikuar. |
| Hartimi i një përmbledhjeje të vendimmarrjes së Komisionerit për të Drejtën e Informimit për çështje me interes publik dhe rastet e kufizimit të informacionit, konceptet e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (vjetore). | Mbledhje e vendimeve të dhëna nga Komisioneri gjatë viteve.<br><br>Hartim i draftit të përmbledhjes së vendimmarrjes. | Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit | Dhjetor 2026 | Përmbledhje e vendimmarrjes së Komisionerit e përfunduar. |

| DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES SË TË DHËNAVE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **OBJEKTIVI** | **MASAT E PËRGJITHSHME** | **NJËSIA PËRGJEGJËSE** | **PERIUDHA** | **PRODUKTI** |
| Monitorimi i zbatimit i legjislacionit për mbrojtjen e i dhënave personale. | Shqyrtimi dhe trajtimi i ankesave nga subjekte të të dhënave personale.<br><br>Zhvillimi i hetimeve administrative mbi bazë ankese për verifikimin e mëtejshëm pranë kontrolluesit.<br><br>Organizimi i seancave dëgjimore për hetimet administrative me bazë ankese.<br><br>Hartimi i akteve përfundimtare.<br><br>Përfaqësimi dhe përgatitja e akteve në të gjitha shkallët e gjyqësorit. | Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale<br><br>Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit | Gjatë vitit | Minimizimi i shkeljeve, respektimi i privatësisë dhe përpunimi i drejtë dhe i ligjshëm i të dhënave personale.<br><br>Rekomandime/Vendime/Urdhra.<br><br>Tabelë statistikore mbi proceset gjyqësore.<br><br>Prapësime, ankimime, etj |
| Dhënia e mendimeve për projektaktet ligjore dhe nënligjore si dhe projektet që kërkohen të zbatohen nga kontrollues publikë dhe që përfshijnë të dhëna personale. | Analizimi i projekt-akteve ligjore dhe nënligjore të ardhura për mendim pranë institucionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Integrimit.<br><br>Trajtimi i rasteve që paraqiten pranë Zyrës së Komisionerit, kthim përgjigje, orientime mbi zbatueshmërinë e detyrimeve të legjislacionit. | Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale<br><br>Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit | Gjatë vitit | Mendime dhe opinione ligjore.<br><br>Sugjerime konkrete mbi zbatimin e projekteve si dhe mbi aspekte për t'u përmirësuar lidhur me to, me qëllim garantimin e përputhshmërisë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.<br><br>Publikimi i dhënies së mendimeve mbi projektaktet e paraqitura në faqen zyrtare web të institucionit www.idp.al. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Garantim i mbrojtjes së të dhënave personale gjatë procesit të transferimit ndërkombëtar të të dhënave. | Trajtimi i praktikave të kërkesave për autorizim të transferimit, të paraqitura pranë Zyrës së Komisionerit.<br><br>Përgatitja e akteve paraprake dhe përfundimtare që kanë lidhje me shqyrtimin e praktikës së transferimit ndërkombëtar.<br><br>Orientim dhe dhënie opinioni ligjor në lidhje me transferimin ndërkombëtar.<br><br>Identifikimi i subjekteve që realizojnë transferim ndërkombëtar dhe realizimi i hetimeve administrative në këta kontrollues. | Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale<br><br>Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit | Gjatë vitit | Vendime për dhënie apo refuzim autorizimi, si dhe orientimi i kontrolluesve në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ligjore. |
| Garantimi i zbatimit të legjislacionit për masat shtesë të sigurisë publike lidhur me regjistrimin e kontrolluesve subjekt të këtij legjislacioni. | Përditësimi i vazhdueshëm i regjistrit të subjekteve në zbatim të ligjit për masat shtesë të sigurisë. | Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale<br><br>Drejtoria e Mbikëqyrjes në Fushën e Drejtësisë Penale dhe Sigurisë Publike | Gjatë vitit | Zbatimi i legjislacionit për masat shtesë të sigurisë publike. |
| Ushtrim i hetimeve administrative me qëllim monitorimin dhe zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga kontrollues publik dhe privat, me fokus të veçantë; | Identifikim i sektorëve të rëndësishëm për t'u kontrolluar.<br><br>Zhvillimi i hetimeve administrative kryesisht.<br><br>Zhvillimi i seancave dëgjimore. | Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale<br><br>Drejtoria e Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave | Gjatë vitit | Garantim i zbatimit të detyrimeve që burojnë nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale gjerësisht mbi bazë sektorësh.<br><br>Rekomandime/Vendime/Urdhra. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ▪ sektori i shërbimit shëndetësor; (qendrat spitalore publike dhe private);<br>▪ sektori i ndërtimit/ konstruksionit;<br>▪ sektori farmaceutik;<br>▪ sektori i transportit (koncesionaret, transport privat);<br>▪ sektori arsimor (shërbimi mësimdhënës pas shkollës);<br>▪ sektorë të ndryshëm në varësi të sensibilitetit, apo problematikave të konstatuara. | Bashkëpunimi me kontrolluesit.<br><br>Hartimi i akteve përfundimtare. | | | |
| Hetime administrative tematike pranë kontrolluesve të cilët i përkasin sektorëve:<br>▪ sektori sigurimeve (tematik, PIMS);<br>▪ ofrues të shërbimeve online (tematik, PIMS). | Përgatitja e Pranit të punës për kontrollet që do të ushtrohen.<br><br>Identifikimi i grupeve të punës.<br><br>Zhvillimi i hetimeve administrative.<br><br>Zhvillimi i seancave dëgjimore.<br><br>Hartimi i akteve përfundimtare.<br><br>Bashkëpunimi me kontrolluesit. | Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale<br><br>Drejtoria e Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave | Gjatë vitit | Garantim i zbatimit të detyrimeve që burojnë nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale me fokus Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit.<br><br>Rekomandime/Vendime/Urdhra. |
| Aktivitete ndërgjegjësuese me qëllim zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga | Fushatë ndërgjegjësuese me drejtues dhe nëpunës të sektorëve të shërbimeve TIK, shëndetësor dhe të | Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale | 6 mujori i parë | Garantim i zbatimit të detyrimeve që burojnë nga ligji për mbrojtjen e të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| kuadri i ri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale me Nëpunësit e Mbrojtjes së të Dhënave të Kontrolluesve. | sigurimeve mbi detyrimet e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. | Drejtoria e Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave | | dhënave personale, në kuadër të veprimtarisë së Kontrolluesve. |
| Monitorim i rekomandimeve të lëna më herët për kontrollues publik dhe privat. | Analizë e njoftimit të kontrolluesve publik dhe privat në adresë të Zyrës së Komisionerit për përmbushjen e rekomandimeve të lëna.<br><br>Zhvillimi i hetimeve administrative për verifikimin e mëtejshëm të përmbushjes së rekomandimeve nga këta kontrollues. | Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale<br><br>Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit<br><br>Drejtoria e Mbikëqyrjes në Fushën e Drejtësisë Penale dhe Sigurisë Publike<br><br>Drejtoria e Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave | Gjatë vitit | Adresimi i problematikës sipas sektorëve përkatës. |
| Hartimi i klauzolave standarde të mbrojtjes së të dhënave. | Draftimi i klauzolave standarde për mbrojtjen e të dhënave në zbatim të ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. | Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale<br><br>Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integrimit | | Klauzola standarde për mbrojtjen e të dhënave të publikuara nga Komisioneri. |
| Monitorim i përputhshmërisë ligjore për funksionimin e bazave të të dhënave të kontrolluesve publik. | Analizë e përputhshmërisë ligjore të kontrolluesve publik mbi krijimin dhe funksionimin e bazave të të dhënave.<br><br>Zhvillimi i hetimeve administrative për verifikimin e mëtejshëm. | Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale<br><br>Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit | | Adresimi i problematikës sipas sektorëve përkatës.<br><br>Garantim i zbatimit të detyrimeve që burojnë nga ligji për mbrojtjen e |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Hartimi i akteve/raporteve përfundimtare. | Drejtoria e Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave<br><br>Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integrimit | | të dhënave personale gjerësisht mbi bazë sektorësh.<br><br>Raporte/akte të hartuara. |
